



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0276**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T.P., Bletaria Egzoni", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL-GJILAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1, me 20/06/2024, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "N.T.P. Bletaria Egzoni" me nr. 2024/276 , e datës, 02/04/2024, kurse vendimi i AK-Komuna e Gjilanit, i datës, 15.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh" me nr. të prokurimit: "651-24-570-1-2-1", anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, operatorit ekonomik OE "N.T.P. Bletaria Egzoni" ", sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.02.2024, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar, Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh" me nr. të prokurimit: "651-24-570-1-2-1". Ndërsa me datën 15.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues , ka shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 24,000.00 €.

Me 20.03.2024, OE “N.T.P. Bletaria Egzoni” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 22.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “N.T.P. Bletaria Egzoni” me nr. 276/24 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me shoqëri bletësh” me nr. të prokurimit: “651-24-570-1-2-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.T.P. Bletaria Egzoni” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): “Fillimisht sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë dhe as ndonjë dëshmi se me çfarë race të bletëve ka ofertuar, ndërsa tek pyetjet sqaruese njëra ndër pyetjet (nr.15) ka qenë si në vijim: Raca e bletëve a duhet të jetë ApisMillifera apo race tjetër, ndërsa përgjigja ishte Raca e kërkuar e bletëve duhet te jete .:Apis mellifica var. carnica Pollm. Këto pyetje dhe përgjigje normalisht që janë pjesë e dosjes së tenderit dhe secili OE është dashur të dëshmojë se raca e bletëve do të jetë Apis mellifica var. carnica Pollm. Ne kemi ofruar deklaratën për racën e bletëve, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë deklaratë apo dëshmi, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. Gjithashtu sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë. Në procesverbal të hapjes çmimi i OE të rekomanduar për kontratë pa TVSH është 15,000.01€, kurse me TVSH 17,000.00 €, ndërsa me TVSH edhe tek njoftimi mbi vendimin është 17,000.00 €. Ne kemi çmimin në procesverbal të hapjes 15,000.00 € pa TVSH, kurse me TVSH 17,000.00€, e po ashtu edhe tek njoftimi mbi vendimin është 17,000.00€. Çmimi i OE të rekomanduar për kontratë në procesverbal të hapjes pa TVSH është më i shtrenjtë se sa çmimi i ofruar nga ne, ndërsa kur i shtohet edhe vlera e TVSH-së atëherë përsëri është me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë. Kur i shtohet TVSH atëherë çmimi i OE të rekomanduar për kontratë është 17,000.01 €. Ndërsa çmimit tonë kur i shtohet TVSH-ja rezulton të jetë 17,000.00 €, e që i bie se ne jemi me çmim më të lirë se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Autoriteti kontraktues e ka shpallur fitues OE të rekomanduar për kontratë kinse ka çmimin e njëjtë me ofertën tonë dhe me arsyetimin se i njëjti ka ofertuar me kohë përpara neve. Është e vërtetë se ky OE ka ofertuar para neve me kohë, mirëpo i njëjti ka çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë dhe në këtë rast nuk vjen në shprehje zbatimi i nenit 39.8 i rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik. Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.22.03.2024, ku autoriteti kontraktues nuk ka mundur të arsyetojë fare këtë vendim. Autoriteti kontraktues mundohet të barazojë deklaratën për specifikime teknike me deklaratën për racën e bletëve, mirëpo ne ju sqarojmë se deklarata për racën e bletëve është dashur të ofrohet veçantë pasi që raca e bletëve nuk ka qenë e përshkruar tek specifikimet teknike, por kjo është cekur tek pyetjet

dhe përgjigjet sqaruese. Me këtë përgjigje të AK-së po kuptohet qartë se edhe vetë autoriteti kontraktues e ka pranuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare deklaratë për racën e bletëve por mundohet ta arsyetojë me deklaratën për specifikime teknik. Sa i përket çështjes së çmimit të OE të rekomanduar për kontratë, AK-së është arsyetuar se çmim është i njëjtë si në procesverbal të hapjes, formular të tenderit dhe tek përshkrimi i çmimeve, ndërsa në sqarojmë se kontestuese këtu është kalkulimi dhe përlllogaritja e çmimit dhe shtimi i TVSH-së çmimit pa TVSH. Pra në këtë rast shihet qartë se vlera e çmimit pa TVSH e OE të rekomanduar për kontratë është më e lartë se sa oferta jonë, prandaj edhe kur i shtohet TVSH-ja përsëri rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është me çmim më të lartë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashihet qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Në këtë rast nuk është respektuar as neni 6 ekonomikiteti sepse nuk është rekomanduar për kontratë oferta me çmimin më të ulët. AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë”.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Illyria” Sh.A konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69 të LPP-së si dhe neni 40 i RrPP-së. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerri: Vendim që të Aprovedhet, si e bazuar ankesa e OE N.T.P “Bletaria Egzoni” të anulohet njoftimi mbi vendimin i AK-së (B58) dhe lënda kthehet në Rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:

“Përgjigja e AK lidhur me këto pretendimet e OE :Autoriteti Kontraktues (AK) - ka vepruar ne harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënie e Kontratës, ku ka rekomanduar ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulte si dhe ne harmoni me Nenin 59 te LPP-se, ka bere ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kriterëve te përcaktuara ne FDT Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për Kontrate. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekconomiciteti dhe Efikasiteti, Nenin 7 Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka trajtuar operatoret ekonomik ne mënyre te barabarte pa diskriminime dhe ka vepruare ne mënyrë transparente. Përfundim Bazuar në te lartcekurat, AK konsideron se ne te gjitha veprimet dhe aktet e AK-së, gjate këtij procesi te prokurimit se ka vepruar ne pajtueshmëri te plote me te gjitha dispozitat përkatëse ligjore te LPP-se dhe legjislacionit sekondar rregullores së prokurimit publik te cilat parashohin dhe rregullojnë kushtet dhe kriteret qe paraqiten gjate një aktiviteti te prokurimit. Duke u bazuar ne arsyet e dhëna me lart, Autoriteti Kontraktues në kuptim te nenit 108/A ne paragrafin 10.1 te LPP-së dhe duke u bazuar ne nenin 63 paragrafi 1.1 pika (b) te lidhur me nenin 62.1 pika (d) te Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka vendosur si ne diapozitiv te këtij vendimi.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02/04/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 276/2024, ndërsa me datë 07/04/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/276 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues: Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues N.T.P Bletaria Egzoni është pjesërisht e Bazuar të Anulohet njoftimi mbi vendimin E AK-së i datës 15.03.2024 mbi dhënien e kontratës. Të kthehet lënda në Rivlerësim, ne bazë te përshkrimit te lartcekur.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtues, po ashtu dhe OE Nuk është Pajtuar me mendimin e ekspertit.

-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE “N.T.P. Bletaria Egzoni” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/276 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Sipas pretendimi ankimor nr. 1, operatorit ekonomik te rekomanduar për kontratë i mungon deklarata apo ndonjë dëshmi tjetër se me çfarë lloje te bletësh ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. Sipas operatorit ekonomik ankues një deklaratë e tillë është kërkuar tek pyetjet sqaruese (pyetja nr 15). Eksperti shqyrtues konstaton se një kërkesë e tillë ne formën e kërkesës dhe dëshmisë nuk është kërkuar te kriteret e përzgjedhjes mirëpo vetëm tek pyetjet sqaruese te datës 13.02.2024, ku AK-KK Gjilan ka specifikuar llojin e bletëve qe duhet ofertuar. AK-KK Gjilan gjatë procedurës se vlerësimit sipas nenit 72 te LPP-së dhe nenit 38 te Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik është dashur te sqaroj me operatorin ekonomik te rekomanduar për kontratë nëse ky operator ekonomik ka ofruar llojin e bletëve sipas kërkesës se pyetjeve sqaruese (pyetja nr.15) te dt.13.02.2024.Rekomandojmë qe një sqarim i tillë sipas nenit 72 te LPP-së dhe nenit 38 te Rregullores për Prokurim Publik , AK-KK Gjilan te i bëjë gjatë procedurës se rivlerësimit te ofertave dhe te sqarohet lloji i ofruar i bletëve sepse nuk mund te shpërblehet një operator ekonomik me kontratë pa përcaktuar llojin e ofruar te furnizimeve.”

Konstatimi i dytë (II) : “Sipas pretendimi ankimor nr 2, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka çmim me te shtrenjtë se operatori ekonomik ankues sepse çmim i ofruar pa TVSH i operatorit ekonomik te rekomanduar për kontratë tek procesi i hapjes është 15,000.01€ ndërsa me TVSH: 17,700.00€, ndërsa operatori ekonomik ankues ka ofertuar çmimin pa TVSH ne shumen prej 15,000.00€ ndërsa me TVSH: 17,700.00€. (Sqarim: Operatori ekonomik ankues ne ankesë vlerës prej 17,700.00€ i referohet si vlerë prej 17,000.00€). Sipas nenit 40.10 te Rregullores për Prokurim publik. Ne rastin përkatës operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar çmim për njësi sipas përshkrimit te çmimeve te tij në shumen prej 118.00€ x150 = 17,7000.00€ pra nuk kemi mos përputhje ne mes çmimit njësi dhe totalit te fituar, shih dëshminë ne vijim: Rekomandojmë AK-KK Gjilan se ne raste te tilla te furnizimeve gjatë përgatitjes se përshkrimit te çmimeve te përdor formën Excel te standardizuar qe e prodhon vetë E-prokurimi dhe në këtë mënyrë kjo te i eliminonte gabimet e mundshme te llogaritjeve nga ana e operatoreve ekonomik. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm, përshkrimin e çmimeve te plotësuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, nenit 40.10 te Rr, 001/2022 për prokurim publik konstatojmë se pretendimi ankimor nr. .2 është i pa bazuar. Në bazë te ankesës se operatorit ekonomik ankues konstatojmë se kemi të bëjmë me dy pretendime ankimore te cilat i kemi trajtuar ne pjesën e mësipërme duke dhënë përgjigjet tona për secilin pretendim ankimor.

Nga kjo rezulton se pretendimi ankimor nr.1 është pjesërisht i bazuar ndërsa pretendimi ankimor nr. 2 është i pabazuar. Pasi që kemi te bëjmë me një pretendim ankimor pjesërisht te bazuar atëherë rekomandojmë kthimin e lëndës në rivlerësim dhe te trajtohet pretendimi ankimor nga autoriteti kontraktues gjatë fazës së rivlerësimit sipas rekomandimeve të dhëna tek përgjigja në pretendimin nr. 1. Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, pyetjeve sqaruese , raportit të vlerësimit, dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore të ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që të Anullohet Vendimi i AK-së i datës 15.03.2024 mbi dhënie e kontratës dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues të konsiderohet pjesërisht e Bazuar, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.”

Bazuar në përshkrimin e mësipërm, pyetjeve sqaruese, dosjen e tenderit dhe shkresave të lëndës konstatojmë se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues: “Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues N.T.P Bletaria Egzoni është pjesërisht e Bazuar të Anullohet njoftimi mbi vendimin E AK-së i datës 15.03.2024 mbi dhënien e kontratës. Të kthehet lënda në Rivlerësim, në bazë të përshkrimit të lartcekur”.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.T.P. Bletaria Egzoni”. Argumentimi në raportin e

ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Vlerësimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.T.P. Bletaria Egzoni” janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues-Komuna Gjilan, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me shoqëri bletësh” me nr. të prokurimit: “651-24-570-1-2-1”. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.T.P. Bletaria Egzoni” dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Vlerësimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.T.P. Bletaria Egzoni” janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me shoqëri bletësh” me nr. të prokurimit: “651-24-570-1-2-1”, të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i dates, 15.03.2024, për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pretendimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues për aprovimin pjesërisht të ankesës së OE “N.T.P. Bletaria Egzoni” anulimin e vendimit AK, dates.15.03.2024 dhe kthimin në rivlerësim të aktivitetit të prokurimit. AK-Komuna Gjilan gjatë procesit të rivlerësimit të veprave në përputhje me vlerësimet e bazuara të pretendimeve ankimore të OE ankues sipas raportit të ekspertit, dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: “Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE N.T.P. Bletaria Egzoni" vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - N.T.P., "Bletaria Egzoni"**
- Arkivës së OSHP-së: